



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**K R Y E T A R I**

Nr.510/10 Prot.

Tiranë më, 20/09/2016

**V E N D I M**

**Nr.110, Datë 20.09.2016**

**PËR**  
**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË**  
**BASHKINË LIBOHOVË "MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE**  
**RREGULLSHMËRISË FINANCIARE"**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të neneve 10, 15 dhe 30, të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

**V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” të ushtruar në Bashkinë Libohovë, për periudhën nga data 01.01.2013 deri më datë 31.12.2015.

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

**A. MASA ORGANIZATIVE:**

**1. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Libohovë, për aktivitetin ekonomik financiar të periudhës 01.01.2011 deri më 31.12.2012 është kryer auditim nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, dhe nga rekomandimet e dërguara me shkresën nr. 352/7, datë 28.06.2013, nuk është zbatuar masa shpërblim dëmi në vlerën **193,594 lekë**.

-Në ish-Komunën Qendër Libohovë është ushtruar auditim nga Auditi i Brendshëm i Prefekturës së Qarkut Gjirokastrë për periudhën nga 01.02.2012 deri më 01.10.2013 dhe rekomandimet e dërguara me shkresën nr. 2018, datë 31.12.2013 për shpërblim dëmi në vlerën **2,770,874 lekë** nuk janë zbatuar.

-Në ish-Komunën Zagori është ushtruar auditim nga Auditi i Brendshëm i Prefekturës së Qarkut Gjirokastrë për periudhën nga 01.05.2012 deri më 31.08.2014 dhe rekomandimet e dërguara me shkresën nr. 3098, datë 02.12.2014 për shpërblim dëmi në vlerën **90,200 lekë** nuk janë zbatuar.

**1.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Libohovë të merren masa për zbatimin e rekomandimeve të pa realizuara të lëna nga auditimi i mëparshëm të arkëtohet nga personat përgjegjës vlera **3,054,668 lekë gjithsej**.

#### **Në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Libohovë nuk ka hartuar rregullore për zbatimin e ligjit për arkivat dhe rregullore të kodit të etikës. Rregullorja e brendshme e miratuar me VKB nr. 7, datë 08.2.2012 nuk trajton funksionet dhe detyrat e strukturës së re e krijuar si rezultat i ndryshimit të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Nuk është formuluar deklarata e vizionit dhe misionit të njësisë, si dhe nuk janë përcaktuar objektivat strategjike afatgjatë sipas VKM nr. 691, datë 29.7.2015 “Për miratimin e strategjisë ndër sektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015-2020”.

Nga Titullari nuk është ngritur një sistem deklarimi efektiv prej menaxherëve kryesor, sepse nuk janë përcaktuar llojet e deklaratave dhe raporteve që duhet ti dorëzohen, afatet dhe frekuenca e tyre. Grupi i menaxhimit strategjik nuk ka funksionuar dhe gjurma e auditimit për proceset kryesore të punës nuk është hartuar nga asnjë sektor. Raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm është formal, nuk e analizon këtë sistem për të nxjerrë dobësitë dhe përmirësuar gjendjen. Si rrjedhim, sistemi i kontrollit të brendshëm nuk është ngritur i plot, ka funksionuar dhe është monitoruar dobët.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e nenit 8, 16, 20, 22, 23, 24 të ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, kapitullin III, shtojcën nr. 5, 7 të “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, udhëzimin nr. 28, datë 15.12.2011 të Ministrit të Financave “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”.

**2.1 Rekomandimi:** Bashkia Libohovë të hartojë rregulloren e re të brendshme të institucionit, në të cilën të përshkruhen në mënyrë të detajuar detyrat e secilit pozicion pune, frekuenca e raportimit të menaxherëve kryesor te Titullari dhe lloji e raporteve, të hartojë strategjinë e zhvillimit të institucionit, deklaratën e vizionit dhe misionit. Të hartohet dhe miratohet rregullore për zbatimin e legjislacionit për arkivat, si dhe rregullorja për kodin etik, regjistri i riskut nga sektorët kryesor dhe gjurma e auditimit për proceset kryesore të punës. Të kryhet nga Titullari në vazhdimësi monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe dobësitë e tij të pasqyrohen në raportin vjetor mbi funksionimin e këtij sistemi, duke marrë masa për përmirësimin e tyre në vitin pasardhës.

#### **Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën 2013-2015 në Bashkinë Libohovë kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës 21 punonjës të administratës dhe në ish Komunën Qendër Libohovë 7 punonjës, të cilët përpara largimit nuk kanë bërë dorëzimin e detyrës me procesverbal. Në urdhrat e largimit të këtyre punonjësve nga Titullari i institucionit nuk janë përcaktuar afate për dorëzimin e detyrës. Mosdorëzimi i detyrës, informacionit elektronik, dosjeve etj., ka krijuar vështirësi për punonjësit të cilët janë emëruar në këto vende pune, duke penguar ecurinë normale të punës në institucion. Veprimet e

mësipërme janë në kundërshtim me pikën 13 të udhëzimit nr. 30 të Ministrit të Financave, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**3.1 Rekomandimi:** Bashkia Libohovë të marrë masa që në rastet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës të punonjësve, apo transferimit të tyre, në urdhrin e nxjerrë nga Titullari për këtë qëllim, të përcaktohet detyrimi i punonjësit dhe afate për dorëzimin e detyrës me procesverbal përpara largimit apo transferimit, si dhe strukturat përkatëse të institucionit të mos bëjnë likuidimin përfundimtar për punonjësën pa u dorëzuar prej tij detyra (dokumentacioni shkresor, elektronik, inventarët etj.).

#### Në vijimësi

**4. Gjetje nga auditimi:** Për të gjithë periudhën e audituar 2013-2015 në Bashkinë Libohovë janë marrë në punë 13 punonjës në pozicione pune që mbulohen nga statusi për nëpunësin civil pa u zbatuar procedurat e rekrutimit, por me urdhër të brendshëm të Titullarit të institucionit, duke mos respektuar parimet e shanseve të barabarta, meritës dhe aftësive profesionale, në kundërshtim me nenin 20, 22 dhe 23 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Në një rast, me vendimin nr. 9, datë 10.09.2015 të Titullarit të institucionit, është marrë në punë një punonjës i Policisë Bashkiake, në emërimin e të cilit konstatohen këto mangësi:

- është emëruar në detyrë pa ju nënshtruar procedurës së përzgjedhjes;
- është emëruar në detyrë pa kaluar në formim në Akademinë e Rendit Publik;
- nuk është nënshkruar kontratë pune me punonjësën përpara emërimit të tij në detyrë.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 11, të urdhrin të përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Ministrit të Rendit Publik, “Për miratimin e rregullores së brendshme Tip, të Policisë Bashkiake dhe të Komunës”.

**4.1 Rekomandimi:** Në rastet e marrjes në punë të punonjësve, pozicioni i punës i të cilëve mbulohen nga statusi për nëpunësin civil, si dhe punonjësve të policisë bashkiake, nga Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Kryetari i Bashkisë, të zbatohen të gjitha procedurat e rekrutimit sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

#### Në vijimësi

**5. Gjetje nga auditimi:** Objektet e ndërtesave të Bashkisë Libohovë dhe të dy Njësive Administrative në vartësi të saj, nuk janë regjistruar në ZVRPP, gjë që ka sjellë mos pasqyrimin real të pronave dhe vlerës së tyre në pasqyrat financiare të institucionit, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001“Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” të ndryshuar, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pasurisë së paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”dhe UKM nr. 3, datë 18.07.2002 dalë në zbatim të tij.

**5.1 Rekomandimi:** Bashkia Libohovë të marrë masat për plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor, regjistrimin në ZVRPP Gjirokastër dhe pasqyrimin në kontabilitet të objekteve të ndërtesave të Bashkisë Libohovë dhe të dy Njësive Administrative në vartësi të saj.

#### Në vijimësi

**6. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të procedurave të blerjeve me vlera të vogla u konstatuan mangësitë si më poshtë:

- Nuk është hartuar kërkesa nga sektorët e interesuar për kryerjen e shpenzimit për blerjet me vlera të vogla;
  - Nuk janë përcaktuar specifikimet teknike të shërbimit, apo mallit që do të blihej;
  - Nuk është ngritur grupi i punës për testimin e tregut për përcaktimin e fondit limit;
- Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Urdhrit e Ministrisë të Financave nr. 33, datë 11.7.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

**6.1 Rekomandimi:** Gjatë realizimit të procedurave të prokurimit me vlera të vogla të përpilohet kërkesa nga sektori i interesuar duke argumentuar domosdoshmërinë e blerjes së mallit apo kryerjes së shërbimit, të përcaktohen specifikimet teknike dhe të llogaritet fondi limit dhe të bëhet dokumentimi i tyre.

#### **Në vijimësi**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nuk mbahet regjistër i veçantë për vërtetimet e ndryshme që lëshohen nga titullari për shërbimet që kryhen ndaj komunitetit dhe për licencat dhe certifikatat e transportit që lëshohen nga zyra e transportit, për therjet e bagëtive që lëshohen nga shërbimi veteriner, për tu krahasuar me arkëtimet në fakt nga çdo qytetar për shërbimin e ofruar, shërbime të cilat kryhen pa pagesë. Ky veprim bie ndesh me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “ *Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*”.

**7.1 Rekomandimi:** Bashkia Libohovë dhe Sektori i Taksave e Tarifave Vendore të Bashkisë, të marrë masa për caktimin e tarifave vendore të dokumenteve zyrtare që lëshohen nga institucioni dhe pas miratimit në Këshillin Bashkiak të administrojë në regjistër të veçantë gjithë dokumentacionin e lëshuar dhe tarifatat e arkëtuara.

#### **Menjëherë**

**8. Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2013, 2014 dhe 2015 vlera prej 2,002,115 lekë që përbën investime të kryera në 33 raste, janë kontabilizuar gabim në llogarinë 602 “shpenzime operative”, nga të cilat në 32 raste në vlerën 1,868,915 lekë i përkasin Bashkisë Libohovë dhe 1 rast në vlerën 133,200 lekë i përket ish -Komunës Zagorie sipas objekteve të përcaktuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Veprimet e mësipërme kanë dhënë informacion të pasaktë në pasqyrat financiare vjetore dhe janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar.

**8.1 Rekomandimi:** Sektori i Financës në Bashkinë Libohovë, të kryejë sistemimin kontabël të vlerës 2,002,115 lekë duke e kaluar nga llogaria nr. 602 “shpenzime operative” në llogarinë 231 “shpenzime për investime”, sipas analizave përkatëse të objekteve.

#### **Menjëherë**

**9. Gjetje nga auditimi:** Si rezultat i veprimeve dhe mos veprimeve të stafit drejtues të Bashkisë Libohovë dhe mos funksionimit të Sektorit të Planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor ndër vite, janë lejuar ndërtime pa leje, ndërtime jashtë kondicioneve urbane dhe zaptime të trojeve publike për objektet:

1. Objekti një kat lokal Bar-Restorant në Përroi i Zhepës ndërtim i qytetarit S.P.
2. Objekti një kat në ndërtim e sipër në Përroi i Zhepës ndërtim i qytetarit F.R.

3. Objekti 3 kat në ndërtim e sipër në lagjen Pazar ndërtim i qytetarit A.Ç.
4. Zaptim i trotuarit në qendër të qytetit Libohovë nga ndërtimi i qytetarëve O.M. dhe Xh.L.
5. Zaptim dhe ndërtim pa leje banese dhe stallë bagëtish i oborrit rrethues të godinës së Bashkisë Libohovë (nga mbrapa).
6. Zaptim i lulishtes tek busti Avni Rustemi nga ndërtimi i lokalit.
7. Zaptim i lulishtes në fund të rrugës hyrëse në qytetin e Libohovës (në krahun e majtë) nga ndërtimi i lokalit.

**9.1 Rekomandimi:** Bashkia Libohovë t'i dërgojë Inspektoratit Mbrojtjes Territorit Kombëtar, praktikat e ankesave të 3 qytetarëve, respektivisht; S.P. F.R. dhe A.Ç. për lejin ose ndërhyrjen në prishjen e ndërtimeve pa leje dhe jashtë kondicioneve urbane si dhe lirim të trojeve të zaptuara dhe kthimin e tyre në gjendjen e mëparshme, bazuar në ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, i ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme".

**Menjëherë**

**10. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi për vitet 2013, 2014 dhe 2015 nga Bashkia Libohovë, nuk është parashikuar dhe ngritur struktura e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit (IMKT, ish-INVU) pranë Bashkisë dhe nuk i ka deleguar me shkresë zyrtare përgjegjësitë dhe detyrat e përcaktuara Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, gjë e cila ka sjellë inefficencë në parandalimin dhe zgjidhjen e problematikave në mbrojtjen e mjedisit urban dhe territorit, në kundërshtim me detyrimet ligjore të përcaktuara në nenet; 4, 5, 6 dhe 18.1 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 i ndryshuar me ligjin nr. 183/2014 datë 24.12.2014 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme".

**10.1 Rekomandimi:** Bashkia Libohovë të marrë masa për ngritjen e strukturës së Inspektoratit Mbrojtjes Territorit (IMKT), pranë Bashkisë Libohovë në përmbushje të nëneneve detyrimet ligjore të përcaktuara në nenet; 6 dhe 18.1 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme".

**Menjëherë**

**11. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën e audituar në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë është paguar Zyra Përmbare për 12 raste në vlerën 722,953 lekë gjithsej, vlerë e cila ka shkaktuar impakt negativ në buxhetin e bashkisë.

**11.1 Rekomandimi:** Për pagesat e kryera nëpërmes Zyrës Përmbare për detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë, para vitit 2013 për 12 rastet në vlerën **722,953 lekë** gjithsej, Këshilli i Bashkisë Libohovë të analizojë veprimet e kryera dhe nxjerrë përgjegjësinë.

**Brenda datës 31.10.2016**

**12. Gjetje nga auditimi:** Sipas vendimit gjyqësor nr. 1001, datë 14.11.2006 të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për dëmin e shkaktuar nga ish Komuna Qendër në kullotën pronë e qytetarit F.R. dëmshpërblyer në vlerën **13,050,000 lekë**, e cila ka sjellë impakt negativ ndaj buxhetit të ish Komunës Qendër Libohovë.

Sipas Vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë nr. 448, datë 27.12.2006, dëmtimi i kullotës së paditësit F.R. nuk është shkaktuar nga veprimi i paligjshëm i ish-Komunës Qendër Libohovë, sepse rruga për në fshatin Labovë është hapur mbi rrugën ekzistuese përjashtuar disa devijime të vogla, me mjetet e Ministrisë së Mbrojtjes dhe me financimin e vetë banorëve të fshatit Labovë. Komuna Qendër Libohovë nuk ka paraqitur dokumentacion për investimin e kryer në këtë segment rrugor, pasi në vitin 2004 kur është kryer rikonstruksioni, rruga ka qenë në administrim të Drejtorisë Rajonale të Rrugëve Gjirokastrë dhe vlerësimi i dëmit nuk është bazuar në kërkesat e VKM nr. 138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që vlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë për interes publik” dhe në nenin 608 të Kodit Civi.

**12.1 Rekomandimi:** Bashkia Libohovë në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Rrugëve Gjirokastrë dhe ZVRPP Gjirokastrë, bazuar në ligjin nr. 8812, datë 17.05.2001 “Kodi i procedurës civile”, neni 472 “Procedurat e rekursit”, të kërkojë në rrugë gjyqësore heqjen e këtij detyrimi që rrjedh nga vendimi gjyqësor i formës së prerë, duke kërkuar vënien në afat dhe rekurs për pronësinë e rrugës së përfituar nga vendimi gjyqësor dhe ish rrugës ekzistuese të shpronësuar sipas vendimit gjyqësor, vlerësimin e sipërfaqes mbi llogaritjes sipas bazës ligjore për shpronësimin dhe jo me vlerën e tregut (sipas ekspertit), me qëllim anulimin e vendimit gjyqësor dhe mos ekzekutimin e detyrimit në vlerën **13,050,000 lekë**.

**Brenda datës 31.10.2016**

**13. Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2013, 2014 dhe 2015 në 17 raste është paguar nga subjekti “[REDACTED]” Dega Gjirokastrë në vlerën **14,788,50 lekë gjithsej**, për detyrimin për kamatëvonesa në likuidimit e shpenzimeve telefonike jashtë afatit kohor. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 35, germa (a), nenin 38 të UKM nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**13.1 Rekomandimi:** Për pagesat e kryera për kamatëvonesa për llogari të subjektit “[REDACTED]” Dega Gjirokastrë në vlerën **14,788,50 lekë gjithsej**, nga të cilat në 13 raste në vlerën 13,123,50 lekë për vitin 2013 dhe 2014 dhe në 4 raste në vlerën 1,665 lekë për vitin 2015, Këshilli i Bashkisë Libohovë të analizojë veprimet e kryera dhe nxjerrë përgjegjësinë.

**Brenda datës 31.10.2016**

**14. Gjetje nga auditimi:** Policia Bashkiake nuk ka dokumentuar veprimet e kryera në bashkëpunim me IKMT për parandalimin dhe prishjen e ndërtimeve të paligjshme, zënien e trojeve, ndërtesave dhe të objekteve. Nuk ka ndërmarrë masat e duhura lidhur me bashkëveprimin dhe dokumentimin e procedurave të kryera nga kjo strukturë si në bashkëpunimin me strukturat e tjera brenda bashkisë, ashtu dhe me institucionet e tjera sipas rastit. Në aktivitetin e kësaj strukture nuk ka bashkëpunim me sektorin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë për vjeljen e debitorëve të taksave vendore. Nga Këshilli Bashkiak nuk është miratuar niveli i gjobave dhe rastet e ndërhyrjes së Policisë Bashkiake.

**14.1 Rekomandimi:** Të miratohet nga Këshilli Bashkiak niveli i gjobave sipas llojit të shkeljeve administrative dhe të aplikohet vendosja e tyre nga Policia Bashkiake në rastet e konstatimit të këtyre shkeljeve.

Struktura e Policisë Bashkiake të vihet në mbështetje të strukturave të tjera të Bashkisë për kontrollin e territorit, vjeljen e taksave vendore dhe administrimin e aseteve.

#### **Në vijimësi**

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk është ndarë detyra për secilin punonjës, nuk është bërë një inventar fizik i dosjeve të vetë Bashkisë Libohovë edhe pse nga ish-komunat është dorëzuar detyra me procesverbal, me qëllim që të evidentohet dokumentacioni që mungonte, njoftim-vlerësimet e detyrimeve tatimore, fotokopje e dokumentit të pagesës së taksave, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial".

**15.1 Rekomandimi:** Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Libohovë të marrë masa për ndarjen e detyrave për secilin punonjës, duke u caktuar numrin e bizneseve sipas NUIS (Nipteve) apo fshatrave për taksën e tokës dhe taksat e popullatës. Dosjet e subjekteve tatimpaguese të plotësohen me deklaratat parashikuese të qarkullimit vjetor, njoftim vlerësimin tatimor, njoftim detyrimi, dokumenti i pagesës së detyrimit, (mandat arkëtimi), gen-planet apo planimetritë për taksën e ndërtesave, akt konstatimet apo akt verifikimet për mbylljen e aktivitetit, në bashkëveprim me Policinë Bashkiake, të përcaktuara në nenin 29 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat tatimore*" i ndryshuar.

#### **Menjëherë**

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk është krijuar regjistri me të dhëna për kontratat e lidhura për dhënien me qira tokat bujqësore të pa ndara, kullotat, pyjet për vend depozitim materialesh inerte, vendosje antenash televizive etj.

**16.1 Rekomandimi:** Zyra e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Libohovë të marrë masa për hapjen e regjistrimit me të dhënat e kontratave të qirasë me të gjitha elementët dhe sipas viteve, duke i ndjekur në vazhdimësi arkëtimin e tyre sipas kushteve të kontratës.

#### **Në vijimësi**

**17. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Libohovë edhe pse ka mazhorancën e aksioneve në Ujësjiellës sh.a Libohovë dhe për vitet 2013-2015 ka pasur në Këshillin Mbikëqyrës 2-3 persona, nuk ka realizuar lidhjen e një marrëveshje, në të cilën Ujësjiellës sh.a. Libohovë të përcaktohet si agjent tatimor për arkëtimin e taksave vendore së bashku me faturat e ujit të pijshëm, bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5 shkronja (ii), neni 7 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore*" i ndryshuar, pikës 7.1 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008 "*Për Procedurat Tatimore*" i ndryshuar, marrëveshje e cila do të rriste arkëtimin e taksave vendore dhe do rigjenerojë të ardhura për Bashkinë Libohovë.

**17.1 Rekomandimi:** Bashkia Libohovë të përgatisë aktmarrëveshjen me Ujësjiellës sh.a. Libohovë, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat e ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak bazuar në legjislacionin në fuqi.

#### **Në mbledhjen më të afërme të Këshillit Bashkiak**

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

Mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa V, kreu I, **Akti administrativ**, nenet 98-102, Kreu V, nenet 9-14 dhe Kreu VII-të “Funksioni dhe kompetencat e njësive të vetëqeverisjes vendore”, nenet 21-33 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, nenet 608-628 në vijim, me ndryshime dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, **nga ana e titullarit të njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim **shpërblimi i dëmit në vlerën 12,512,551 lekë**, nga të cilat në shpenzime **5,195,551 lekë** dhe mungesë në të ardhura nga mos regjistrimi i taksave vendore në shumën **7,317,000 lekë**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga dhënia me qira e kullotave deri në vitin 2016 konstatohet mos arkëtim i detyrimeve të prapambetura të kontratave në 6 raste në vlerën **1,266,800 lekë** e cila përbën dëm ekonomik dhe konkretisht dy kontrata të lidhura në vitin 2013 dhe katër kontrata në vitin 2014.

**1.1 Rekomandimi:** Vlëra **1,266,800 lekë** gjithsej e cila përbën detyrimin për 6 kontratat e qirasë së kullotave të kontabilizohet si detyrim dhe të zhdëmtohet nga 6 qiramarrësit si vijon:

**1. F.C.** në vlerën **369,800 lekë** gjithsej pasi:

- Në ekonominë kullimore Zagori, në parcelën nr. 62, J.F.K Çajup, sipas kontratës për periudhën nga 01.06.2013-30.11.2013 duhet të paguante vlerën **199,800 lekë** dhe kontratës datë 05.06.2013 në vlerën **170,000 lekë** ose gjithsej detyrimi për të dy kontratat për vitin 2013 në vlerën **369,800 lekë**, të cilën nuk e ka paguar.

**2. B.B.** në vlerën **222,000 lekë** gjithsej pasi:

- Në ekonominë kullimore Zagori, në parcelën nr. JFK Çajup, ka lidhur kontratë për periudhën nga 01.06.2013-30.11.2013, ku rezulton se nuk ka paguar detyrimin në vlerën **222,000 lekë**.

**3. I.N.** në vlerën **240,000 lekë** pasi:

-Në ekonominë kullimore Zagori, në parcelën JFK, Çajup sipas kontratës nr. 136, datë 03.06.2014 ku rezulton se nuk ka paguar detyrimin në vlerën **240,000 lekë**.

**4. Th.G.** në vlerën **156,000 lekë** pasi:

- Në ekonominë kullimore Zagori, në parcelën nr. 51, Çajup, ka lidhur kontratë qiraje për periudhën 3 vjeçare nga data 01.06.2014-30.11.2016 në vlerën 234,000 lekë, nga të cilat ka arkëtuar me mandat arkëtimin nr. 12, datë 06.06.2014 vlerën 78,000 lekë, duke mbetur pa paguar detyrimin në vlerën **156,000 lekë**.

**5. Sh.H.** në vlerën **139,000 lekë** pasi:

- Në ekonominë kullimore Zagori, parcelën nr. 54,55,56, Hija e mallkuar, ka lidhur kontratë qiraje për periudhën 3 vjeçare nga data 01.06.2014-30.11.2016, në vlerën



208,500 lekë, nga të cilat ka arkëtuar me mandat arkëtimin nr. 13, datë 06.06.2014 vlerën 69,500 lekë, duke mbetur pa paguar detyrimin në vlerën **139,000 lekë**.

**6. A.B. në vlerën 140,000 lekë pasi:**

- Në ekonominë kullosore Zagori, në parcelën nr. 30,31,32,33 Rrëza Topovë, ka lidhur kontratë qiraje për periudhën 3 vjeçare nga data 01.06.2014-30.11.2016, në vlerën 210,000 lekë, nga të cilat ka arkëtuar me mandat arkëtimin nr. 14, datë 10.06.2014 vlerën 70,000 lekë, duke mbetur pa paguar detyrimin në vlerën **140,000 lekë**.

**Deri më 31.12.2016**

**2. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Libohovë, ish Komunën Qendër Libohovë dhe Zagorie, për vitet 2013, 2014 dhe 2015 janë bërë pagesa për shpërblim të këshilltarëve të këshillit bashkiak dhe komunal për muaj në të cilët nuk kanë marrë pjesë në asnjë mbledhje të këshillit, duke u shpërblyer për punë të pakryer, jo në përputhje me pikën 2 të nenit 29, pikën 2 dhe 9 të nenit 31 të ligjit nr. 8652 “*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*” i ndryshuar, duke sjellë përfundimin padrejtësisht në total të vlerës **1,034,454 lekë cila përbën dëm ekonomik** dhe duhet të dëmshpërblehet prej tyre. Konkretisht në Bashkinë Libohovë janë shpërblyer 16 këshilltarë, duke përfituar vlerën 413,083 lekë, në ish Komunën Qendër Libohovë 13 këshilltarë, duke përfituar vlerën 312,068 lekë dhe në ish Komunën Zagorie 9 këshilltarë, duke përfituar vlerën 309,303 lekë.

**2.1 Rekomandimi:** Bashkia Libohovë të kontabilizojë detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **1,034,454 lekë**, përfituar padrejtësisht nga 16 ish anëtarët e këshillit bashkiak dhe 22 ish anëtarët e këshillit të komunave.

**Brenda datës 31.12.2016**

**3. Gjetje nga auditimi:** Në prokurimin “*Shërbimi i pastrimit, gjelbërimit dhe mirëmbajtjes së varrezave të qytetit Libohovë për vitin 2013*”, duke i marrë të mirëqena sipërfaqet dhe çmimet e preventivuar, nga veprimet dhe mos veprimet e preventivuesit, njësisë së prokurimit dhe komisionit të vlerësimit të ofertave në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe në kualifikimin, shpalljen e fituesit dhe lidhjen e kontratës të shërbimit ndaj Bashkisë Libohovë, është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **499,852 lekë** gjithsej e detajuar si më poshtë:

- Vlera e fondit limit të përlllogaritur sipas preventivit mbi vlerën e punimeve për 7 zërat e punës në vlerën 2,876,411 lekë është shtuar padrejtësisht vlera **490,981 lekë** si rezultat i përfshirjes në llogaritje në masë 8% shpenzime plotësuese, në masën 10% fitimi dhe në masën 1,5% tatim fitimi, veprim në kundërshtim me pikën 2,3 dhe 9 të VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “*Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit*”, ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26.09.2012.

-Vlera e preventivit të ofertës fituese është llogaritur në vlerën 1,514,061 lekë pa TVSH ndërsa kontrata e shërbimit të pastrimit fillon me datë 21.06.2013 dhe përfundon me datë 31.12.2013 ose duhej llogaritur për 191 ditë në vlerën 1,505,190 lekë d.m.th. është llogaritur më tepër në vlerën **8,871 lekë**.

**3.1 Rekomandimi:** Vlera **499,852 lekë**, që përbën diferencën e fondit limit të llogaritur më tepër, të kontabilizohet si detyrim dhe zhdëmtohet nga operatori ekonomik “A.Ç.”.

**Brenda datës 30.11.2016**

**4. Gjetje nga auditimi:** Në tenderin e zhvilluar me objekt *“Rikonstruksion i ujësjellësve të fshatrave të Komunës Zagorie”* në zbatim të kontratës për punë publike nr. 4 datë 21.07.2014 punimet duhet të përfundonin brenda 20 ditëve ose në date 10.08.2014 por në fakt sipas certifikatës të marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve nr. 14 datë 19.09.2014 punimet kanë përfunduar me 39 ditë vonesë për të cilat nuk është aplikuar sanksion për ditë vonesa në dorëzimin e punimeve sipas përcaktimeve të bëra kontratën e mësipërme bazuar në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës neni 24.1 Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar pika a e DST vlera e kontratës 3,052,675 lekë x 39 ditë vonesa x 4/000 lekë për ditë vonesë baras në vlerën **476,217 lekë**, pa TVSH, e cila përbën detyrim për arkëtim nga përfituesi.

**4.1 Rekomandimi:** Vlera **476,217 lekë**, që përbën detyrimin për vonesa në dorëzimin e punimeve të kontabilizohet si detyrim dhe të zhdëmtohet nga operatori ekonomik “

**Brenda datës 30.11.2016**

**5. Gjetje nga auditimi:** Në prokurimin *“Shërbimi i pastrimit, gjelbërimit dhe mirëmbajtjes së varrezave të qytetit Libohovë për vitin 2014”*, vlera e fondit limit të përlllogaritur sipas preventivit mbi vlerën e punimeve për 7 zërat e punës në vlerën 2,781,163 lekë është shtuar padrejtësisht vlera **474,711 lekë**, si rezultat i përfshirjes në llogaritje në masë 8% shpenzime plotësuese, në masën 10% fitimi dhe në masën 1,5% tatim fitimi, veprim në kundërshtim me pikën 2,3 dhe 9 të VKM nr. 514, datë 15.08.2007 *“Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”*, ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26.09.2012.

**5.1 Rekomandimi:** Vlera **474,711 lekë**, që përbën diferencën e fondit limit të llogaritur më tepër, të kontabilizohet si detyrim dhe zhdëmtohet nga përfituesi operatori ekonomik “

**Brenda datës 30.11.2016**

**6. Gjetje nga auditimi:** Në prokurimin me objekt *“Mirëmbajtje të kanaleve anësorë të segmentit rrugor Labovë e Sipërme- Labovë e Poshtme”* në ish Komunën Qendër Libohovë, janë prokuruar tre zëra punimesh si 1) gjërmim kanalesh me krahë në tokë të fortë me seksion deri 0.75 m<sup>2</sup>, 2) gjërmim kanalesh me krahë në tokë të zakonshme, 3) gjërmim për nivelim të shtresave në rrugë, në vlerë totale prej 327,000 lekë, të cilët janë procese pune që duhet të kryheshin nga punonjësit organik të mirëmbajtjes së rrugëve, të miratuar nga Këshilli Komunalë në strukturën e komunës, posaçërisht për kryerjen e këtyre punimeve.

Vlera prej **327,000 lekë** për tre zërat e mësipërm është shpenzim i pajustificuar dhe përbën dëm ekonomik për buxhetin e ish Komunës Qendër Libohovë dhe duhet të zhdëmtohet nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. G K dhe tre anëtarët e komisionit të prokurimit me vlera të vogla, z. E.T. zj. A.Ll. zj. A.B.

**6.1 Rekomandimi:** Të kontabilizohet detyrimi **327,000 lekë** dhe të kërkohet me të gjitha rrugët e mundshme ligjore zhdëmtimi nga ish Titullari i institucionit z. G K dhe anëtarët e KBV-së z. E.T. zj. A.Ll. zj. A.B. në vlerën 81,750 lekë secili.

**Brenda datës 30.11.2016**

**7. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr. 242 datë 10.12.2013 në vlerën 241,363 lekë është paguar subjekti *“* për kryerjen e shërbimit të pastrimit gjelbërimit të qytetit Libohovë për muajin dhjetor 2013. Dokumentacioni i paraqitur nuk

justifikon pagesën e kryer pasi vlera 241,363 lekë, pasi të gjitha volumet e shërbimeve të kryera për pastrimin dhe gjelbërimin e qytetit, të paraqitura nga sipërmarrësi i takojnë gjithë muajit dhjetor 2013 dhe jo periudhës nga 01.12.2013 deri më 10.12.2013, d.m.th. sipërmarrësi duhej paguar për 10 ditë pune në vlerën 77,859 lekë dhe jo për 31 ditë pune, për rrjedhojë operatori ekonomik ka përfituar punë të pa kryer për 21 ditë pune në vlerën **163,504 lekë**, e cila përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik dhe detyrim për arkëtim nga përfituesi.

**7.1 Rekomandimi:** Sektori i Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e pagesës së tepërt nga operatori ekonomik “ [REDAKTUAR] ” në vlerën **163,504 lekë**.

**Brenda datës 30.11.2016**

**8. Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2014 dhe 2015 në ish Komunën Qendër (me urdhër shpenzimin nr. 21 datë 12.02.2014, nr. 27 datë 25.02.2014, nr. 65 datë 07.05.2014 dhe nr. 28 datë 03.04.2015) për 14 raste për 7 punonjës, në vlerën **156,000 lekë**, janë paguar pa faturën tatimore me TVSH shpenzimet e fjetjes në hotel, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, konkretisht: pikën (b), paragrafi III të VKM nr. 997, datë 10.12.2010, veprim i cili përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik dhe detyrim për arkëtim nga përfituesit.

**8.1 Rekomandimi:** Sektori i Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e detyrimit nga 7 ish punonjësit përfitues në vlerën **156,000 lekë**, si më poshtë: G.K. në vlerën 30,000 lekë, Th.K. në vlerën 39,000 lekë, E.Ç. në vlerën 30,000 lekë, F.Z. në vlerën 27,000 lekë, A.M. në vlerën 9,000 lekë, A.B. në vlerën 12,000 lekë, A.B. në vlerën 9,000 lekë.

**Brenda datës 31.12.2016**

**9. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr. 299 datë 22.12.2014 në vlerën 215,343 lekë dhe urdhër shpenzimin nr. 300 datë 22.12.2014 në vlerën 43,373 lekë (gjithsej 258,716 lekë) është paguar subjekti “ [REDAKTUAR] ” për kryerjen e shërbimit të pastrim gjelbërimit të qytetit Libohovë për muajin dhjetor 2014. Dokumentacioni i paraqitur nuk justifikon pagesën e kryer pasi vlera 258,716 lekë e shërbimeve të kryera për pastrimin dhe gjelbërimin e qytetit, të paraqitura nga sipërmarrësi, i takon gjithë muajit dhjetor 2014 dhe jo periudhës nga 01.12.2014 deri më 16.12.2014, d.m.th. sipërmarrësi duhej paguar për 16 ditë pune në vlerën 133,531 lekë dhe jo për 31 ditë pune, për rrjedhojë operatori ekonomik “ [REDAKTUAR] ” ka përfituar punë të pa kryer për 15 ditë pune në vlerën **125,185 lekë**, e cila përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik dhe detyrim për arkëtim nga përfituesi.

**9.1 Rekomandimi:** Sektori i Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e pagesës së tepërt nga operatori ekonomik “ [REDAKTUAR] ” në vlerën **125,185 lekë**.

**Brenda datës 30.11.2016**

**10. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr. 105 datë 20.10.2014 në vlerën 778,800 lekë me TVSH është paguar subjekti “ [REDAKTUAR] ” për blerjen e autoveturës sipas faturës nr. 217 datë 01.10.2014 nënshkruar nga ish-titullari i Komunës z. A.M. Sipas faturës nr. 217 datë 01.10.2014 dorëzimi i autoveturës është realizuar me 46 ditë vonesë për të cilat nuk është aplikuar sanksion për ditë vonesa në dorëzimin e punimeve sipas përcaktimeve të bëra kontratën e mësipërme bazuar në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës neni 24.1 Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar pika (a) e DST vlera e

kontratës 649,000 lekë x 46 ditë vonesa x 4/000 lekë për ditë vonesë = **119,416 lekë** pa TVSH, e cila përbën mos përmbushje të kushteve të kontratës dhe detyrim për arkëtim nga përfituesi.

**10.1 Rekomandimi:** Vlera **119,416 lekë**, që përbën detyrimin për vonesa në dorëzimin në afat të autoveturës të kontabilizohet si detyrim dhe të kërkohet zhdëmtimi nga operatori ekonomik “**[REDACTED]**”.

**Brenda datës 31.10.2016**

**11. Gjetje nga auditimi:** Për muajin gusht, shtator dhe dhjetor 2015 në Bashkinë Libohovë janë emëruar dhe paguar në vlerën **117,510 lekë**, mbi strukturën e miratuar nga Këshilli Bashkiak tre punonjës, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKB nr. 42, datë 05.08.2015 dhe VKB nr. 75, datë 13.11.2015 “Për miratimin e strukturës” dhe ngarkon me përgjegjësi zj. L.M. me detyrë Kryetare e Bashkisë dhe zj. E.Ç. me detyrë përgjegjëse e financës.

**11.1 Rekomandimi:** Sektori i Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e detyrimit nga zj. L.M. dhe zj.E.Ç. në vlerën **58.755 lekë** secila.

**Brenda datës 30.11.2016**

**12. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën e audituar (me urdhër shpenzimin nr. 103, datë 05.06.2013 për 5,000 lekë, nr. 286, datë 11.12.2014 për 15,000 lekë, nr. 33, datë 17.02.2015 për 30,000 lekë, nr. 58, datë 25.02.2015 për 55,000 lekë dhe nr. 348, date 18.12.2015 për 5,000 lekë) janë paguar shpërblime lindje ku rezultoi se në 22 raste për vlerën **110,000 lekë** gjithsej pagesat janë kryer me certifikatë lindjeje të pavlefshme, veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile” neni 27 pika1, neni 42 pika 2.

**12.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e pagesave të tepërta kryer me certifikatë lindjeje të pavlefshme nga 22 persona në vlerën **110,000 lekë**.

**Brenda datës 30.11.2016**

**13. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr. 193, datë 26.06.2015 në vlerën 122,001 lekë dhe urdhër shpenzimin nr. 194, datë 26.06.2015 në vlerën 9,597 lekë (në total vlera 131,598 lekë) për llogari të subjektit “**[REDACTED]**” është kryer pagesë për pastrim gjelbërimin e qytetit për periudhën 16.06.2015 deri më 31.07.2015.

Shpenzimet e kryera për shërbimin e pastrim gjelbërimin të qytetit Libohovë, si më sipër, nuk janë të justifikuar pasi preventivi i ofertës fituese në vlerën 190,000 lekë është llogaritur për 45 ditë, nga data 16.06.2015 deri më 31.07.2015 (190,000 lekë: 45 ditë pune) d.m.th mesatarisht 4,222,22 lekë/ditë ndërsa në situacionet e shërbimeve nga data 18.06.2015 deri 26.06.2015 ose për 8 ditë pune është situacionuar dhe paguar vlera 131,598 lekë ndërkohë që sipas përlllogaritjeve duhej paguar vlera 33,778 lekë ( 8 ditë pune x 4,222,22 lekë/ditë) ose paguar më tepër vlera **97,820 lekë**, i cili përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik dhe detyrim për arkëtim nga përfituesi.

**13.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e detyrimit nga subjekt “**[REDACTED]**” në vlerën **97,820 lekë**.

**Brenda datës 30.11.2016**

**14. Gjetje nga auditimi:** Për një periudhë 1 vjeçare prill 2014-mars 2015 në ish Komunën Qendër Libohovë, janë tërhequr nga magazina për automjetin e Komunës tip Audi me targa AA 504 AU, gjashtë goma dhe një fener, nga të cilat katër goma dhe një

fenet në vlerën 45,450 lekë janë tërhequr nga drejtuesja e mjetit zj. A.B. ndërsa dy goma në vlerën 34,740 lekë janë tërhequr nga drejtuesi tjetër i mjetit z. Th.K. Nuk argumentohet kërkesa për blerje të pjesëve të mësipërme, si dhe tërheqja e tyre nga magazina nga drejtuesit e automjetit, duke i ngarkuar ata me përgjegjësi për zhdëmtimin e tyre në vlerën totale **80,190 lekë**.

**14.1 Rekomandimi:** Bashkia Libohovë të kontabilizojë detyrimin prej **80,190 lekë** dhe të kërkojë me të gjitha rrugët e mundshme ligjore arkëtimin e saj, prej së cilës **45,450 lekë** nga zj. A.B. dhe **34,740 lekë** nga z. Th.K.

**Brenda datës 31.10.2016**

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në tre raste, në muajin Korrik 2015, janë kompensuar me pagesë pushimet vjetore të pakryera në vlerën **65,321 lekë** gjithsej, për ish Kryetarin e Bashkisë z. A.Ç. për 12 ditë pune, ish Kryetarin e Komunës Qendër Libohovë z. G.K. dhe ish Kryetarin e Komunës Zagorie z. A.M. nga 19 ditë pune secili, veprime në kundërshtim me pikën 3 të VKM nr. 463, datë 16.06.2011 “*Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 511, datë 24.10.2002, për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore*”, të ndryshuar.

**15.1 Rekomandimi:** Bashkia Libohovë të kontabilizojë dhe të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit, shpërbelimin e dëmit në vlerën **65,321 lekë** gjithsej nga tre ish titullarët si më poshtë:

-A.Ç. në vlerën **24,671 lekë**, Gentian Koçi në vlerën **20,325 lekë** dhe A.M. në vlerën **20,325 lekë**.

**Brenda datës 31.10.2016**

**16. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr. 35, datë 19.05.2015 në vlerën 743,520 lekë për llogari të subjektit “[REDAKTUAR]” është kryer pagesë për hapje trase rruge në fshatin Vithuq dhe rikonstruksion qendra e fshatit Ndëran. Punimet duhet të përfundonin brenda 5 ditëve ose në datë 13.05.2015 sipas certifikatës të marrjes në dorëzim të punimeve datë 19.05.2015 punimet kanë përfunduar me 6 ditë vonesë për të cilat nuk është aplikuar sanksion për ditë vonesa në dorëzimin e punimeve sipas përcaktimeve të bëra dokumentet e mësipërme bazuar në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës neni 24.1 Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar pika a e DST vlera e kontratës 743,520 lekë x 6 ditë vonesa x 4/000 lekë për ditë vonesë baras në vlerën **17,845 lekë**, pa TVSH, e cila përbën tejkallim afati në dorëzimin e punimeve dhe detyrim për arkëtim nga përfituesi

- Edhe në objektin rikonstruksion i ambienteve të brendshme të shkollës “Andon Zako Çajupi”, në vlerën 910,080 lekë punimet duhet të përfundonin brenda 5 ditëve ose në datë 13.05.2015 por sipas faturës të punimeve nr. 5 datë 18.05.2015 punimet kanë përfunduar me 5 ditë vonesë për të cilat nuk është aplikuar sanksion për ditë vonesa në dorëzimin e punimeve sipas përcaktimeve të bëra dokumentet e mësipërme bazuar në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës neni 24.1 Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar pika a e DST vlera e kontratës 910,080 lekë x 5 ditë vonesa x 4/000 lekë për ditë vonesë baras në vlerën **18,202 lekë**, pa TVSH, e cila përbën tejkallim afati në dorëzimin e punimeve dhe detyrim për arkëtim nga përfituesi [REDAKTUAR].

**16.1 Rekomandimi:** Vlera **36,047 lekë gjithsej**, që përbën dëm të shkaktuar nga dorëzimi me vonesë i punimeve në dy objekte, të kontabilizohet si detyrim dhe të kërkohet zhdëmtimi nga operatori ekonomik “ [REDACTED] ” përfitues.

**Brenda datës 31.10.2016**

**17. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr. 29, datë 20.05.2015 për llogari të subjektit “ [REDACTED] ” është kryer pagesë për rikonstrukcion qendra e fshatit Ndëran. Nga auditimi në dokumentacionin justifikues të shpenzimet e kryera u konstatua se pagesa për “*Diferencë transporti*” në vlerën **35,000 lekë** pa TVSH është e pa justifikuar dhe përbën detyrim për arkëtim nga përfituesi operatori ekonomik “ [REDACTED] ” për të cilën mban përgjegjësi titullari i institucionit dhe komisioni i blerjeve me vlera të vogla z. V.Gj. z. P.M. dhe zj. F.V.

**17.1 Rekomandimi:** Vlera **35,000 lekë**, që përbën pagesë të punimeve të pa kryera, të kontabilizohet si detyrim dhe të kërkohet zhdëmtimi nga operatori ekonomik përfitues “ [REDACTED] ”

**Brenda datës 31.10.2016**

**18. Gjetje nga auditimi:** Në prokurimin “**Blerje karburanti për vitin 2013**” në ish Komunën Zagorie, nga auditimi i dokumenteve të tenderit rezulton se duhej të ishte shpallur fitues operatori ekonomik “ [REDACTED] ” pasi oferta ekonomike është më e ulët, me marzhin 13 lekë/litër, ose çmimin 157.61 lekë/litër pa TVSH, kundrejt ofertës me marzh 15 lekë/litër, ose çmimin 159,61 lekë/litër pa TVSH të operatorit ekonomik “ [REDACTED] ” sh.a. të shpallur fitues.

Diferenca e çmimeve midis dy ofertave është 2 lekë/litër (159,61 – 157,61) dhe për sasinë e furnizuar prej 5,221 litra vlera e paguar tepër rezulton në vlerën **10,534 lekë** pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 55 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikën 4, germa (g), kreu v të VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Vlera e mësipërme përbën dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi KVO z. V.Gj. z. P.M. dhe zj. V.T.

**18.1 Rekomandimi:** Vlera **10,534 lekë**, që përbën diferencën midis ofertës së operatorit ekonomik që duhej të shpallej fitues, por të skualifikuar dhe operatorit ekonomik të shpallur fitues në mënyrë të pa rregullt, të kontabilizohet si detyrim dhe zhdëmtohet nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave z. V.Gj. z. P.M. dhe zj. V.T. në vlerën 3,512 lekë secili.

**Brenda datës 31.10.2016**

**19. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Libohovë në datën 31.12.2015 nuk janë pasqyruar si debitorë në Pasqyrat Financiare 2015, gjithsej 83 **biznese në vlerën 7,317,000 lekë**, nga e cila 6,321,702 lekë janë detyrime të papaguara, ndërsa **815,298 lekë** përfaqëson kamat vonesa për mos pagesa në afat. Nga auditimi rezulton se për vitet 2013, 2014 dhe 2015 nuk janë nxjerrë listat e debitorëve dhe nuk janë dërguar në zyrën e financës, për tu regjistruar si debitorë duke mos hapur analizat (partitarët), në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore të mëposhtme:

-Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 6 dhe 7; Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4 pika 26, neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues” dhe Udhëzimi i

Ministrit Financave nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, rubrika “Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve” pika 3.

**19.1 Rekomandimi:** Nga Zyra e Financës dhe Taksave Vendore të Bashkisë Libohovë të merren masa për regjistrimin në kontabilitet si debitorë në vlerën **17,685,000 lekë** gjithsej, të krijohet regjistri elektronik, të merren masa për arkëtimin dhe të bëhen njoftim vlerësimet tatimore për 83 **biznese debitorë në vlerën 7,317,000 lekë**, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore”, i ndryshuar, (pavarësisht kërkesave të mëparshme duke i rikërkuar vazhdimisht) dhe ndjekur rrugët e mëposhtme:

**a.** Tu dërgohen Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore”.

**b.** Ti kërkohet Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit vendosja e barrës siguroese, (mjetet) dhe ZVRPP (për pasuritë) bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

**c.** Zyra e taksave për mos pagesën e taksave në afat të aplikojë dënim me gjobë për pagesat e vonuara, në masën 0,06% kamat vonesë për çdo ditë vonesë por jo më tepër se 365 ditë, bazuar në nenin 114 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për procedurat Tatimore”, i ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 15.12.2014.

**d.** Nga ana e Zyrës së taksave Bashkia Libohovë të listohen në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të merren masa për arkëtimin e taksave të tokës **nga 1158 fermerë** për vlerën **8,268,000 lekë**, taksa e popullatës për shumën **2.300.000 lekë**, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile. Në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të MF nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, të njoftohen tatimpaguesit familjarë me Njoftim vlerësimi tatimor **edhe në median lokale** (të Bashkisë Libohovë dhe 2 njësitë Administrative Qendër Libohovë dhe Zagorie), për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, nëpërmjet dërgimit të njoftim vlerësimit me anë të zyrës postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, banesave dhe tarifrat etj. Gjendja e debitorëve në shkallë Bashkie Libohovë më datën 31.12.2015 në mënyrë të përmbledhur paraqitet më poshtë:

Emërtimi	Sipas bilancit kontabël më datë 31.12.2015	Sipas listave analitike				Debitor tjer,ndert pastr etj 000/lek	Totali Debitorëve ne 000 /Leke
		Biznese private		Debitorët e Tokës			
		Numri	000/lek	Numri	000/lek		
Bashkia Libohovë	Nuk jane regj në kontab	58	<b>6.400</b>	557	<b>4.900</b>	1.100	<b>12,400</b>
Njesia Adm. Qendër	Nuk jane regj në kontab	21	<b>500</b>	422	<b>2.800</b>	1.000	<b>4,300</b>
Njesia Adm. Zagorie	Nuk jane regj në kontab	4	<b>417</b>	136	<b>568</b>	200	<b>985</b>
<b>SHUMA</b>		<b>83</b>	<b>7.317</b>	<b>1.158</b>	<b>8.268</b>	<b>2.300</b>	<b>17,685</b>

**Menjëherë**

### **C. MASA DISIPLINORE:**

#### **Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.**

**I** - Mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore” shkronja “b”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në

komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë që ti kërkojë komisionit disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

**“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”,** parashikuar në nenin 58 shkronja (c), **për 1 punonjës** sa vijon:

**1.Znj. E.Ç.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Nëpunës Zbatues, në Bashkinë Libohovë, nga data 29.07.2015 e në vazhdim dhe ish Përgjegjëse e Financës dhe Nëpunës Zbatues në Komunën Qendër Libohovë nga 01.01.2013 deri 28.07.2015, për shkeljet e mëposhtme:

- Për mangësitë në dokumentacionin bashkëlidhur urdhrave të shpenzimit të bankës për blerjet me vlera të vogla ku mungonte kërkesa për blerjen e mallit ose kryerjen e shërbimit nga sektorët përkatës të miratuar nga Nëpunësi Autorizues.

-Për mos ndjekjen e zbatimit të afateve të kontratave të sipërmarrjes për punë, shërbime publike dhe mallra dhe mos aplikimin e sanksioneve për ditë vonesa në dorëzimin e punimeve/shërbimeve/mallrave sipas përcaktimeve të bëra nenin 2 të kontratës bazuar në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës neni 24.1 “Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar” pika “a” e DST.

-Në muajin Korrik 2015 ka kryer pagesa duke kompensuar me pagesë pushimet vjetore të pakryera në vlerën **65,321 lekë** gjithsej, për ish Kryetarin e Bashkisë z. A.Ç. ish Kryetarin e Komunës Qendër Libohovë z. G.K. dhe ish Kryetarin e Komunës Zagorie z. A.M. veprime në kundërshtim me VKM nr. 463, datë 16.06.2011 “*Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 511, datë 24.10.2002, për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore*”, të ndryshuar, pika 3.

-Për vitin 2014 dhe 2015 në ish-Komunën Qendër (me urdhër shpenzimit nr. 21 datë 12.02.2014, nr. 27 datë 25.02.2014, nr. 65 datë 07.05.2014 dhe nr. 28 datë 03.04.2015) për 14 raste , për shtatë persona janë paguar në vlerën **156,000 lekë** shpenzimet e fjetjes në hotel, në kundërshtim me pikën (b), paragrafi III të VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”.

- Në detyrën e Nëpunësit Zbatues dhe Përgjegjës të Financës në ish Komunën Qendër Libohovë, pa e kontrolluar ka lejuar që të kryhet pagesa për tre zëra punimesh në vlerën **327,000 lekë**, shpenzim i pajustificuar që përbën dëm ekonomik për buxhetin e ish Komunës Qendër Libohovë.

- Për vitet 2013, 2014 dhe 2015 nuk ka pasqyruar në pasqyrat financiare vjetore listat e debitorëve për taksat vendore si në periudhën kur ka qenë Përgjegjëse e Zyrës së Financës në ish-Komunën Qendër Libohovë, dhe pas bashkimit në Bashkinë Libohovë, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 6 dhe 7 dhe ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4 pika 26, neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”.



## **C-II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës**

Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, neni 9, pika 2, i **rekomandojmë** kryetarit të Bashkisë fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore.

### **“Vërejtje me paralajmërim për zgjidhjen e kontratës së punës” për 4 punonjësit e mëposhtëm:**

**1. A.I.** me detyrë përgjegjës i zyrës taksave në Bashkinë Libohovë nga data 01.01.2013 e në vazhdim në cilësinë e anëtarit të KBV pasi:

-Për vitet 2013, 2014 dhe 2015 nuk janë nxjerrë listat e debitorëve dhe nuk janë dërguar në zyrën e financës për tu regjistruar si debitorë për Bashkinë Libohovë dhe nuk janë ndjekur procedurat ligjore për arkëtimin e taksave vendore për **83 biznese në vlerën 7,317,000 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar.

-Për mos llogaritjen e kamat vonesave për pagesat e vonuara të taksave në masën 0,06% kamat vonesë për çdo ditë vonesë por jo më tepër se 365 ditë, në kundërshtim me nenin 114 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore”, i ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 15.12.2014.

**2. F.Z.** me detyrë përgjegjës i zyrës taksave në ish Komunën Qendër Libohovë nga data 01.01.2013 e në vazhdim pasi:

Për vitet 2013, 2014 dhe 2015 nuk janë nxjerrë listat e debitorëve dhe nuk janë dërguar në zyrën e financës për tu regjistruar si debitorë për Bashkinë Libohovë dhe nuk janë ndjekur procedurat ligjore për arkëtimin e taksave vendore për **21 subjekte në vlerën 4,300,000 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar.

-Për mos llogaritjen e kamat vonesave për pagesat e vonuara të taksave në masën 0,06% kamat vonesë për çdo ditë vonesë por jo më tepër se 365 ditë, në kundërshtim me nenin 114 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore”, i ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 15.12.2014.

**3. V.K.** me detyrë inspektor i taksave vendore në Komunën Zagorie nga 25.07.2015 e në vazhdim pasi:

Për vitet 2013, 2014 dhe 2015 nuk janë nxjerrë listat e debitorëve dhe nuk janë dërguar në zyrën e financës për tu regjistruar si debitorë për Bashkinë Libohovë, nuk janë ndjekur procedurat ligjore për arkëtimin e taksave vendore për **4 subjekte dhe 136 fermerë në vlerën 985,000 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar.

-Për mangësitë e konstatuara në ndjekjen dhe zbatimin e kontratave për dhënien me qira të kullotave të Komunës Zagorie, nga ku u konstatua se për 2 raste nuk është aplikuar

tarifa përkatëse e qirasë së kullotës së dhënë me qira dhe në 4 raste nuk është arkëtuar vlera **1,266,800 lekë** e qirasë sipas kushteve të kontratës, respektivisht dy kontrata të lidhura në vitin 2013 dhe katër kontrata në vitin 2014.

**4. S.S.** me detyrë inspektor i Policisë Bashkiake në Bashkinë Libohovë nga data 01.01.2013 e në vazhdim pasi:

-Nuk ka hartuar dokumentacion për pasqyrimin e aktivitetit ditor të shërbimit si, libra shërbimi etj, nuk ka hartuar plane pune, nuk ka vendosur asnjë gjobë për shkelje administrative në territorin e bashkisë, nuk ka bashkëpunuar me zyrën e taksave dhe tarifave vendore për arkëtimin e debitorëve dhe me zyrat e tjera të bashkisë për probleme që lidhen me administrimin e territorit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, nenin 8 të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës”, i ndryshuar dhe urdhrin e përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 07.04.2003 dhe Ministrit të Rendit publik nr. 823, datë 11.04.2003 “Për miratimin e rregullores tip të policisë bashkiake dhe të komunës”.

#### **“Vërejtje” për 2 punonjësit e mëposhtëm:**

**1. S.Z.** me detyrë inspektor i zyrës taksave në Bashkinë Libohovë nga data 25.08.2015 e në vazhdim për arsye:

- Nuk janë nxjerrë listat e debitorëve për 23 subjekte dhe nuk janë dërguar në zyrën e financës, për tu regjistruar si debitorë për Bashkinë Libohovë dhe nuk janë ndjekur procedurat ligjore për arkëtimin e taksave vendore për **23 subjekte në vlerën 2,426,476 lekë**, nga e cila taksë e papaguar në vlerën 1,941,180 lekë dhe kamatëvonesa në vlerën 485,296 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar.

-Për mos llogaritjen e kamat vonesave për pagesat e vonuara të taksave në masën 0,06% kamat vonesë për çdo ditë vonesë por jo më tepër se 365 ditë, në kundërshtim me nenin 114 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore”, i ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 15.12.2014.

**2. E.SH.** me detyrë inspektor i Policisë Bashkiake në Bashkinë Libohovë nga data 01.08.2015 e në vazhdim pasi:

Nuk ka hartuar dokumentacion për pasqyrimin e aktivitetit ditor të shërbimit si libra shërbimi etj, nuk ka hartuar plane pune, nuk ka vendosur asnjë gjobë për shkelje administrative në territorin e bashkisë, nuk ka bashkëpunuar me zyrën e taksave dhe tarifave vendore për arkëtimin e debitorëve dhe me zyrat e tjera të bashkisë për probleme që lidhen me administrimin e territorit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, nenin 8 të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës”, i ndryshuar dhe urdhrin e përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 07.04.2003 dhe Ministrit të Rendit publik nr. 823, datë 11.04.2003 “Për miratimin e rregullores tip të policisë bashkiake dhe të komunës”

#### **D. MASA ADMINISTRATIVE:**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike në nenit 4, 12, 28, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalin nr. 2 datë 10.06.2016, vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës përkatëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në 12 procedurat e prokurimeve publike, apo rekomandimin e Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), ndaj **7 ish punonjësve** si më poshtë:

##### ***a. Njësia e Prokurimit***

- 1. A.F.** me detyrë juriste
- 2. Q.T.** me detyrë përgjegjës i zyrës së urbanistikës
- 3. D.B.** me detyrë financiere

Në tenderat me objekt “**Shërbimi i pastrimit, gjelbërimit dhe mirëmbajtjes së varrezave të qytetit Libohovë për vitin 2013 dhe për vitin 2014**”, pasi në të dy procedurat mungon urdhri për ngritjen e grupit të punës për hartimin e preventivit të pastrimit të qytetit Libohovë, fondi limit nuk është përcaktuar mbi matje faktike të sipërfaqeve të rrugëve, trotuareve, sipërfaqeve të gjelbëruara dhe skica përkatëse të tyre, nga ana e Njesisë së Prokurimit u është bërë ftesë operatorëve ekonomik, pa asnjë argumentim se si janë përzgjedhur këta operator ekonomik, çfarë aktiviteti tregtar ushtrojnë dhe ku e ushtrojnë, në preventiv nuk është përcaktuar distanca e transportit të mbeturinave, janë përcaktuar 7 zëra punimesh, çmimet dhe vlera e tyre pa analizë analitike, pa hartë treguese dhe mbi totalin e shpenzimeve është shtuar padrejtësisht 19,5% vlera e shpenzimeve (përfshirë shpenzimet plotësuese, fitimin dhe tatimin) në kundërshtim me pikën 2,3 dhe 9 të VKM nr. 514, datë 15.08.20017 “Për informatizimin e llogaritjes së koston dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26.09.2012 dhe me kërkesat nenit 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

##### ***b. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.***

- 1. L.B.** me detyrë përgjegjës i sekt. të financës, në cilësinë e kryetarit të KVO.
- 2. B.Ç.** me detyrë inxhinier i jashtëm, në cilësinë e anëtarit të KVO.
- 3. G.H.** me detyrë specialist i bujqësisë, në cilësinë e anëtarit të KVO.
- 4. F.R.** me detyrë specialist i bujqësisë, në cilësinë e anëtarit të KVO.

Ofertuesi i kualifikuar dhe shpallur fitues nga KVO është person fizik dhe nuk disponon licencë profesionale të lëshuar nga Ministria e Punëve Publike, nuk ka paraqitur

dokumentacion të automjetit të transportit të mbeturinave dhe nuk ka paraqitur dokumentacion për pagesën e sigurimeve shoqërore të pesë punonjësve sipas nenit 12 të kushteve të kontratës, veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit Publik”i ndryshuar, për rrjedhojë ndaj Bashkisë Libohovë është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **499,852 lekë** për vitin 2013 dhe në vlerën **474,711 lekë për vitin 2014**.

**Shënim:** Për 22 ish-punonjësit e larguar nga puna për arsye të reformës territoriale, të Bashkisë dhe ish-Komunave Qendër Libohovë dhe Zagorie, nuk rekomandojmë masa disiplinore sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë këto masa nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit e tyre.

***Ish punonjësit e Bashkisë Libohovë, të Komunës Qendër Libohovë dhe të Komunës Zagorie.***

1. A.Ç. me detyrë ish Kryetar i Bashkisë Libohovë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues për periudhën 01.01.2013 deri 31.07.2015
2. L.B. me detyrë ish përgjegjëse e sektorit të financës në Bashkinë Libohovë në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe të kryetarit të KVO për periudhën 01.01.2013 deri 11.08.2015
3. D.P. me detyrë ish përgjegjës i sektorit të financës në Bashkinë Libohovë për periudhën 01.09.2014 deri 02.07.2015
4. G.H. me detyrë ish specialist i bujqësisë në Bashkinë Libohovë në cilësinë anëtarit të KVO
5. F.R. me detyrë inspektor i zyrës taksave vendore në Bashkinë Libohovë për periudhën 01.01.2013 deri më 29.07.2015
6. E.G. me detyrë inspektor i zyrës taksave vendore në Bashkinë Libohovë për periudhën 27.04.2013 deri më 21.08.2015
7. Q.T. me detyrë ish përgjegjësi zyrës së shërbimeve të Bashkisë në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit dhe të KBV për periudhën 01.01.2013 deri më 29.07.2015
8. A.F. me detyrë juriste në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit në Bashkinë Libohovë për periudhën 01.01.2013 deri më 29.07.2015
9. D.B. me detyrë financiere në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit në Bashkinë Libohovë për periudhën 01.01.2013 deri më 29.07.2015
10. B.Ç. me detyrë inxhinier ndërtimi specialist i jashtëm në cilësinë anëtarit të KVO në Bashkinë Libohovë.
11. G.K. me detyrë ish Kryetar i Komunës Qendër Libohovë në cilësinë Nëpunësit Autorizues për periudhën 01.01.2013 deri 07.07.2015
12. A.B. me detyrë juriste në Komunën Qendër Libohovë për periudhën 20.04.2015 deri 30.06.2015 në cilësinë anëtarit të KBV në Komunën Qendër Libohovë për periudhën 20.03.2015 deri 30.06.2015
13. E.T. me detyrë inspektor arsimit në Komunën Qendër Libohovë për periudhën 20.04.2015 deri 30.06.2015

14. A.B. me detyrë inspektore arsimi në Komunën Qendër Libohovë për periudhën 01.01.2013 deri 31.12.2014
15. Th.K. me detyrë inspektor urbanistike në Komunën Qendër Libohovë për periudhën 02.03.2015 deri 30.06.2015
16. E.H. me detyrë inspektor i zyrës taksave vendore në Komunën Qendër Libohovë për periudhën 01.11.2011 deri më 12.08.2015
17. A.M. me detyrë ish Kryetar i Komunës Zagorie në cilësinë Nëpunësit Autorizues për periudhën 01.01.2013 deri 07.07.2015
18. V.Gj. me detyrë ish përgjegjës i sektorit të financës në Komunën Zagorie në cilësinë Nëpunësit Zbatues dhe të kryetarit të KVO e KBV për periudhën 01.01.2013 deri 31.07.2015
19. P.M. me detyrë përgjegjës i zyrës së urbanistikës në Komunën Zagorie në cilësinë anëtarit të KVO e KBV për periudhën 01.01.2013 deri 31.07.2015
20. V.T. me detyrë inspektore e ndihmës ekonomike në Komunën Zagorie në cilësinë anëtarit të KVO për periudhën 01.01.2013 deri 31.07.2015
21. F.V. me detyrë përgjegjëse e zyrës së taksave vendore në Komunën Zagorie në cilësinë anëtarit të Njësisë së Prokurimit dhe KBV për periudhën 01.01.2013 deri 31.07.2015.
22. F.M. me detyrë inxhinier ndërtimi specialist i jashtëm në cilësinë anëtarit të Njësisë së Prokurimit në Komunën Zagorie.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor dhe Departamenti Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**